

Në mbështetje të nenit 48, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14); nenit 40, paragrafi 3 dhe nenit 14, paragrafët 3 dhe 9 i Ligjit të Veprimtarisë me Valuta të Huaja ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11 dhe 188/13) dhe në mbështetje të pikës 9 të Vendimit për mënyrën dhe procedurën e raportimit të transaksioneve të jorezidentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/14), guvernatori i Bankës së Republikës së Maqedonisë miratoi:

UDHËZIM
PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E RAPORTIMIT TË GJENDJES DHE TË
NDRYSHIMEVE TË INVESTIMEVE TË REZIDENTËVE NË LETRAT ME VLERË
NË TREGJET E HUAJA FINANCIARE
(tekst i konsoliduar jozyrtar)¹

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcakton mënyrën, procedurën dhe afatet e raportimit, formën dhe përmbajtjen e formularëve të raportimit për gjendjen dhe ndryshimet e investimeve të rezidentëve në letrat me vlerë të tregtuara në tregjet e huaja financiare.

Rezidentët të cilët, në përputhje me ligjin, mund të investojnë në letra me vlerë në tregjet e huaja financiare (në tekstin e mëtejshëm: investuesit) njoftojnë Bankën Popullore të shtetit dhe ndryshimet në investimet në të gjitha letrat me vlerë të tregtuara në tregjet e huaja financiare, të cilat i kanë në portofolin e tyre.

2. Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim:

- **Gjendja e investimit** në letra me vlerë paraqet numrin e letrave me vlerë që investuesi ka në portofolin e tij dhe vlerën e investimeve në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit.
- **Ndryshimet e investimit** përfshijnë të gjitha transaksionet me letra me vlerë që janë bërë në periudhën e raportimit, si dhe lëvizjet e tjera, përkatësisht ndryshimet e çmimeve dhe ndryshimet e tjera në investime (si rezultat i riklasifikimit, fshirjes, etj.).

¹ Ky është një tekst jozyrtar i rishikuar i Udhëzimit për mënyrën dhe procedurën e raportimit të gjendjes dhe të ndryshimeve të investimeve të rezidentëve në letra me vlerë në tregjet e huaja financiare. Teksti i konsoliduar jozyrtar mbulon: Udhëzimin për mënyrën dhe procedurën e raportimit të gjendjes dhe të ndryshimeve të investimeve të rezidentëve në letrat me vlerë në tregjet e huaja financiare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 108/14), Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për mënyrën dhe procedurën e raportimit të gjendjes dhe të ndryshimeve të investimeve të rezidentëve në letrat me vlerë në tregjet e huaja financiare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/15) dhe Udhëzimit për ndryshimin e Udhëzimit për mënyrën dhe procedurën e raportimit të gjendjes dhe të ndryshimeve të investimeve të rezidentëve në letra me vlerë në tregjet e huaja financiare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 200/16).

- **Aksione dhe letra të tjera pronësore me vlerë** janë letrat me vlerë me të cilat investuesi fiton të drejtën e zotërimit të një pjese të ndërmarrjes - emetuese e letrave me vlerë, në mënyrë proporcionale me numrin e letrave me vlerë që zotëron në totalin e kapitalit dhe që mund t'i japë atij të drejtën e votës, të drejtën e dividetit dhe të drejtën për një pjesë të mbetur të vlerës së ndërmarrjes.
- **Vërtetime për zotërimin e letrave me vlerë (GRD)** paraqesin dëshmi të pronësisë së letrave me vlerë të emetuara nga emetues të huaj, të cilat lehtësojnë tregtimin me letrat me vlerë të emetuara në tregjet e huaja (jashtë vendit të emetuesit).
- **Pjesë të aksioneve dhe aksione në fonde të investimit** janë pjesë aksionesh, përkatësisht aksione të emetuara nga fondet e investimeve.
- **Letra me vlerë të borxhit** janë letra me vlerë që i japin investuesit të drejtën për kryegjë dhe/ose interes në një periudhë të ardhshme.
- **Kodi ISIP** paraqet numër ndërkombëtar për identifikimin e letrave me vlerë.

II. MËNYRË E RAPORTIMIT

3. Investuesit dorëzojnë në këto raporte në Bankën Popullore: VHV - 1 Raport për gjendjen dhe ndryshimet e investimeve në letrat pronësore me vlerë dhe pjesët e aksioneve në fondet e investimeve (në tekstin e mëtejshëm: formulari VHV -1) dhe VHV - 2 Raport për gjendjen dhe ndryshimet e investimeve në letrat me vlerë të borxhit (në tekstin e mëtejshëm: formulari VHV-2). Forma dhe përmbajtja e formularëve VHV-1 dhe VHV-2 përcaktohen me këtë udhëzim.

4. Investuesit raportojnë në Bankën Popullore në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë.

Raportimin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të paragrafit 1 të kësaj pike, për investuesit: shoqëritë e sigurimit, fondet e investimeve dhe fondet e pensioneve, e bën në emër të tyre rregullatori përkatës. Saktësia e të dhënave të paraqitura dhe raportimi në kohë është përgjegjësi e investuesit.

5. Investuesit që raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe rregullatorët (në tekstin e mëtejshëm: raportuesit) raportojnë në baza mujore deri 20 (njëzet) ditë pas përfundimit të muajit për të cilin raportohet.

6. Raportimi bëhet në mënyrë elektronike.

III. MËNYRË E PLOTËSIMIT TË FORMULARËVE

7. Raportuesi raporton për të gjitha letrat me vlerë që investuesi ka në portofolin e tij. Raportohet sipas parimit "letër me vlerë pas letrës me vlerë", përkatësisht secila rresht i formularëve duhet të përmbajë të dhëna për secilën letër me vlerë.

. Shenja kryesore për identifikimin e letrave me vlerë është kodi i tyre ISIN, me përjashtim të atyre letrave me vlerë që janë emetuar pa këtë shenjë. Raportimi bëhet në valutën origjinale, pra në valutën e emetimit të letrës me vlerë.

Letrat me vlerë që nuk kanë një kod ISIN identifikohen nga shenja që raportuesi e përdor në regjistrat e tij.

8. Të dhënat kryesore për raportuesit plotësohen në aplikacionin për pranimin elektronike të të dhënave, në përputhje me Udhëzimet Teknike për Aplikacionin e-VHV.

9. Investimet në aksione dhe letra të tjera pronësore, duke përfshirë pjesë të aksioneve në fondet e investimeve, raportohen në formularin VHV-1.

Pjesa **1. "Investues"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **1.1 "Numri i amzës"** shënohet numri i amzës i investuesit (nga regjistri i shoqërive tregtare të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë) i cili zotëron letra me vlerë, përkatësisht numri i identifikimit për fondet e pensione dhe të investimeve, i caktuar nga rregullatori i tyre.
- Në fushën **1.2 "Emri"** shkruhet emri i plotë i investuesit.
- Në fushën **1.3 "Sektori institucional"** shkruhet kodi i sektorit ku bën pjesë investuesi. Shtojcë-numërori i sektorëve të investuesve (në përputhje me Vendimin për klasifikimin kombëtar të sektorëve institucionalë) është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 1. Sektori i investuesit.

Pjesa **2. "Letër me vlerë"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **2.1. "Lloji i shenjës së l.v."** shkruhet kodi i markës së letrës me vlerë, përkatësisht: 1 - për letrën me vlerë të emetuar **me** kodin ISIN ose 2 - për letrën me vlerë të emetuar **pa** kodin ISIN.
- Në fushën **2.2. "Kodi ISIN i l.v."** shkruhet numri ndërkombëtar i identifikimit të letrës me vlerë. Nëse fusha 2.1 "Lloji i shenjës së l.v." është shënuar me kodin 2 - letër me vlerë e emetuar pa kod ISIN, në fushën 2.2 shënohet shenja që raportuesi përdor në procesverbalin e tij për identifikimin e letrës me vlerë.
- Në fushën **2.3 "Lloji i l.v."** shkruhet shifra e llojit të letrës me vlerë. Shtojcë-numërori i llojeve të letrave me vlerë është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 2. Llojet e letrave me vlerë.
- Në fushën **2.4 "Valuta e emetimit"** shifra e valutës në të cilën është emetuar letra me vlerë shkruhet nga numërori i valutave, i cili është pjesë

përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave jashtë vendit.

- Në fushën **2.5 "Çmimi nominal i një l.v."** shkruhet çmimi nominal i emetimit të letrave me vlerë.
- Në fushën **2.6 "Tregu/bursa e transaksioneve"** shkrihet shenja/emri ndërkombëtar i tregut/bursës ku është tregtuar letra.
- Në fushën **2.7 "Shteti i tregut të tregtimit"** shkruhet shifra e shtetit në të cilin ndodhet tregu financiar ku u tregtua letra me vlerë, nga numërori i shteteve, e që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave jashtë vendit.
- Në fushën **2.8 "Valuta e tregtimit"** shkruhet shifra e valutës në të cilën është kryer transaksioni me letrën me vlerë, nga numërori i valutave, e që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.

Pjesa 3. **"Emetues i letrave me vlerë"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Fusha **3.1 "Numri i amzës"** plotësohet vetëm nëse objekti i investimit është një letër me vlerë e emetuar nga një rezident në një treg financiar të huaj. Në të njëjtën kohë shënohet edhe numri i identitetit të emetuesit të letrës me vlerë, nga regjistri i personave juridikë, të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.
- Në fushën **3.2 "Emri dhe selia"** shkruhet emri i plotë dhe selia e emetuesit të letrës me vlerë.
- Në fushën **3.3 "Shteti"** shkruhet shifra e shtetit në të cilin ndodhet selia e emetuesit të letrës me vlerë, nga numërori i shteteve, e që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.
- Në fushën **3.4 "Sektori institucional"** shkruhet shifra e sektorit të cilit i përket emetuesi i letrës me vlerë. Shtojcë - numërori i sektorëve të emetuesve është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 3. Sektori i emetuesit.
- Në fushën **3.5 "Lloji i lidhjes me emetuesin"** shënohet me një nga kodet këto shifra: 1 - nëse investuesi ka pjesëmarrje prej *më pak se 10%* në kapitalin e emetuesit ose 2 – nëse investuesi ka pjesëmarrje *prej 10% ose mbi 10%* në kapitalin e emetuesit.

Pjesa e kushteve dhe ndryshimet plotësohet në valutën e emetimit të letrës me vlerë.

Pjesa 4. **"Gjendja në fillim të periudhës"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **4.1 "Numri i l.v. në fillim të periudhës"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi kishte në portofolin e tij në fund të periudhës së mëparshme të raportimit.
- Në fushën **4.2 "Çmimi i tregut i një l.v. në fillim të periudhës"** shkruhet çmimi i tregut me të cilin vlerësohet letra me vlerë në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së mëparshme të raportimit*. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ka treg aktiv dhe çmimet e të cilave nuk kuotohen në një bursë përkatëse, shkruhet çmimi me të cilin vlerësohet letra në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së mëparshme të raportimit*.

Të dhënat e shënuara në pjesën 4. "Gjendja në fillim të periudhës" duhet të jenë identike me të dhënat që u shënuan në pjesën 7. "Gjendja në fund të periudhës" të Raportit VHV-1 për periudhën e mëparshme.

Pjesa 5. "Transaksione me letra me vlerë" plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **5.1.1 "Numri i l.v. të blera"** shkruhet numri i letrave me vlerë të blera nga investuesi gjatë periudhës së raportimit.
- Në fushën **5.1.2 "Çmimi i tregut i një l.v."** shkruhet çmimi i tregut me të cilin është blerë letra me vlerë. Nëse gjatë periudhës së raportimit, investuesi blen në mënyrë të përsëritur të njëjtën letër me vlerë, çmimi mesatar i ponderuar i tregut shkruhet nga çmimet e tregut të të gjitha blerjeve të letrës përkatëse me vlerë. Numri i letrave me vlerë të blera gjatë periudhës së raportimit merret si ponder. Në të njëjtën kohë, çmimi i tregut nuk duhet të përfshijë komisionet dhe shpenzimet e tjera të ndërmjetësimit që lidhen me transaksionin.
- Në fushën **5.2.1 "Numri i l.v. të shitura"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi ka shitur gjatë periudhës së raportimit.
- Në fushën **5.2.2 "Çmimi i tregut i një l.v."** shkruhet çmimi i tregut me të cilin është shitur letra me vlerë. Nëse gjatë periudhës së raportimit, investuesi shet të njëjtën vlerë shumë herë, çmimi mesatar i ponderuar i tregut shkruhet nga çmimet e tregut të të gjitha shitjeve të letrës përkatëse me vlerë. Numri i letrave me vlerë të shitura gjatë periudhës së raportimit merret si ponder. Në të njëjtën kohë, çmimi i tregut nuk duhet të përfshijë komisionet dhe shpenzimet e tjera të ndërmjetësimit që lidhen me transaksionin.

Operacionet me letrat me vlerë që jepen si garanci, për shembull, në bazë të marrëveshjeve repo të lidhura, nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ka asnjë ndryshim në portofol. Këto vazhdojnë të jenë në portofolin e investuesit që i përdor si kolateral dhe për rrjedhojë duhet të tregohen në bilancin përfundimtar të letrave me vlerë. Ngjashëm, letrat me vlerë të marra si kolateral, për shembull, në bazë të marrëveshjeve të anasjella të repove, nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me

vlere" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofolin e investuesit. Këto letra me vlerë nuk duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar.

Po ashtu, letrat me vlerë që janë dhënë hua në bazë të marrëveshjes së huadhënies së letrave me vlerë, nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ka ndryshim në portofol. Këto vazhdojnë të jenë në portofolin e investuesit dhe në përputhje me rrethanat, duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar të letrave me vlerë. Ngjashëm, letrat me vlerë të marra hua në bazë të marrëveshjes së huadhënies së letrave me vlerë nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofolin e investuesit. Këto letra me vlerë nuk duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar.

Pjesa 6. "Lëvizje të tjera" plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **6.1 "Ndryshime çmimi"** shkruhet vlera e të gjitha ndryshimeve që lindin në bazë të dallimeve të çmimeve gjatë periudhës së raportimit, të cilat ndikojnë në vlerën e gjendjes së investimeve në fund të periudhës së raportimit. Ndryshimet pozitive të çmimeve futen me parashenjë pozitive, ndërsa ato negative me parashenjë negative.
- Në fushën **6.2 "Ndryshime të tjera në numrin e l.v."** shkruhet numri i letrave me vlerë, i cili ndikon në gjendjen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit dhe që mund të burojnë nga riklasifikimi ndërmjet sektorëve institucionalë, ndarja dhe/ose bashkimi i aksioneve, fshirjet, e të tjera, gjatë periudhës së raportimit. Ndryshimet e tjera të shënuara që shkaktojnë rritjen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit futen me parashenjë pozitive, ndërsa ndryshimet që shkaktojnë uljen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit futen me parashenjë negative.
- Në fushën **6.3 "Ndryshime të tjera në shumë"** shkruhet vlera e të gjitha ndryshimeve të tjera në shumë, të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës së raportimit, të cilat shkaktojnë një ndryshim në gjendjen e investimeve në fund të periudhës së raportimit. Këto ndryshime mund të burojnë nga riklasifikimi ndërmjet sektorëve institucionalë, ndarja dhe/ose bashkimi i aksioneve, fshirjet, e të tjera, gjatë periudhës së raportimit. Ndryshimet e tjera që shkaktojnë rritjen e bilancit përfundimtar të investimeve futen me parashenjë pozitive, ndërsa ndryshimet që shkaktojnë uljen e bilancit përfundimtar të investimeve futen me parashenjë negative.

Pjesa 7. "Gjendja në fund të periudhës" plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **7.1 "Numri i l.v. në fund të periudhës"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi ka në portofolin e tij në fund të periudhës së raportimit.
- Në fushën **7.2 "Çmimi i tregut i një l.v. në fund të periudhës"** shkruhet çmimi i tregut me të cilin vlerësohet letra me vlerë në portofolin e investuesit në *fund e periudhës së raportimit*. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ka treg

aktiv dhe çmimet e të cilave nuk kuotohen në një bursë përkatëse, shkruhet çmimi me të cilin vlerësohet letra në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së raportimit*.

Formula e mëposhtme përdoret për të kontrolluar saktësinë e bilancit mbyllës të investimeve në letra me vlerë:

- Bilanci mbyllës = bilanci fillestar + blerja e l.v. (në periudhën e raportimit) - shitja e l.v. (në periudhën e raportimit) + +/- ndryshime në çmim (në periudhën e raportimit) +/- ndryshime të tjera në shumë (në periudhën e raportimit).

Pjesa **8. "Të ardhura"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **8.1 "Dividend"** shkruhet shuma e dividendit që është ndarë për pagesë gjatë periudhës së raportimit sipas numrit të letrave me vlerë të zotëruara. Data e ndarjes së dividendit është data kur investuesi fiton të drejtën e dividendit („ex-dividend date”). Nëse data e ndarjes për pagesën e dividendit nuk dihet, data e mbledhjes së dividendit mund të përdoret sipas rastit. Gjithashtu, në këtë fushë shkruhet edhe shuma e të ardhurave nga investimet në aksione të fondeve të investimit.
- Fusha **8.2 "Fitim i riinvestuar"** plotësohet vetëm nëse raportohet për investime në pjesë të aksioneve dhe aksione të fondeve të investimit. Duke vepruar kështu, shuma e fitimit të mbajtur të realizuar gjatë periudhës së raportimit shkruhet si dallim ndërmjet fitimit dhe dividendit të ndarë për pagesë në periudhën e raportimit, që i përket investuesit për periudhën e raportimit.

Pjesa **9. "Shpenzime"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **9.1 "Shpenzime të ndërmjetësimit"** shkruhet shuma e komisioneve dhe e shpenzimeve të tjera të ndërmjetësimit në lidhje me të gjitha transaksionet e blerjes, shitjes dhe ruajtjes së letrës me vlerë përkatëse, të ndodhura gjatë periudhës së raportimit. Në të njëjtën kohë, futem shpenzimet e ndërmjetësimit të bëra vetëm për ndërmjetësuesin financiar *jorezident*, përkatësisht shpenzimet e mbajtjes së letrës me vlerë të bëra vetëm për bankën depozituese *jorezidente*.

10. Investimet në letrat me vlerë të borxhit raportohen në formularin VHV-2.

Pjesa **1. "Investues"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **1.1 "Numri i amzës"** shkruhet numri i amzës i investuesit (nga regjistri i shoqërive tregtare të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë) i cili zotëron letra me vlerë, përkatësisht numri i identifikimit për fondet e pensioneve dhe të investimeve, të caktuar nga rregullatorët e tyre.
- Në fushën **1.2 "Emri"** shkruhet emri i plotë i investuesit.

- Në fushën **1.3 "Sektori institucional"** shkruhet shifra e sektorit ku bën pjesë investuesi. Shtojcë-numëratori i sektorëve të investuesëve (në përputhje me Vendimin për klasifikimin kombëtar të sektorëve institucionalë) është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 1. Sektori i investuesit.

Pjesa **2. "Letra me vlerë"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **2.1. "Lloji i shenjës së l.v."** shkruhet shifra e shenjës së letrës me vlerë, përkatësisht: 1 - për letrën me vlerë të emetuar **me** kodin ISIN ose 2 – për letrën me vlerë të emetuar **pa** kodin ISIN.
- Në fushën **2.2. "Kodi ISIN i l.v."** shkruhet numri ndërkombëtar i identifikimit të letrës me vlerë. Nëse në fushën 2.1 "Lloji i shenjës së l.v" është shënuar kodi 2 - letër me vlerë të emetuar pa kodin ISIN, në fushën 2.2 shënohet shenja që raportuesi përdor në regjistrat e tij për identifikimin e letrës me vlerë.
- Në fushën **2.3 "Lloji i l.v."** shkruhet shifra për llojin e letrës me vlerë. Shtojcë-numëratori i llojeve të letrave me vlerë është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 2. Llojet e letrave me vlerë.
- Në fushën **2.4 "Valuta e emetimit"** shkruhet shifra e valutës në të cilën është emetuar letra me vlerë, nga numëratori i valutave që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.
- Në fushën **2.5 "Çmimi nominal i një l.v"** shkruhet çmimi nominal me të cilin është emetuar letra me vlerë.
- Në fushën **2.6 "Tregu/bursa e transaksionit"** shkruhet shenja/emri ndërkombëtar i tregut/bursës në të cilën tregtohet letra me vlerë.
- Në fushën **2.7 "Shteti i tregut të tregtimit"** shkruhet shifra e shtetit në të cilin ndodhet tregu financiar ku tregtohet letra me vlerë, nga numëratori i shteteve që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.
- Në fushën **2.8 "Valuta e tregtimit"** shkruhet shifra e valutës në të cilën është kryer transaksioni me letrën me vlerë, nga numëratori i valutave që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.
- Në fushën **2.9 "Lloji i normës së interesit"** shkruhet shifra e llojit të normës së interesit. Shtojcë-numëratori i llojeve të normave të interesit është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 4. Llojet e normave të interesit.
- Në fushën **2.10 "Lartësia e normës së interesit (%)"** shkruhet lartësia e normës së interesit në përqindje me katër shifra dhjetore. Kur norma e interesit është fikse, shkruhet lartësia e normës nominale të interesit të përcaktuar sipas kushteve të emetimit të letrës me vlerë. Kur norma e

interesit është e ndryshueshme, shkruhet shuma e marzhit (pjesa fikse mbi normën e ndryshueshme të interesit), nëse është parashikuar në momentin e emetimit të letrës me vlerë.

- Në fushën **2.11 "Frekuenca e pagesave në vite"** shkruhet numri i shlyerjeve të interesit gjatë një viti kalendarik, përkatësisht: 0 - pa interes, 1 - vjetore, 2 - gjysmëvjetore, 4 - tremujore, 6 - dymujore, 12 mujore, 24 - dyjavore ose 99 – e mbetur.
- Në fushën **2.12 "Data e emetimit"** shkruhet dita, muaji dhe viti kur është emetuar letra me vlerë, në formatin dd.mm.vvvv.
- Në fushën **2.13 "Data e maturimit"** shkruhet dita, muaji dhe viti kur maturohet letra me vlerë, në formatin dd.mm.vvvv.

Pjesa **3. "Emetues i letrave me vlerë"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Fusha **3.1 "Numri i amzës"** plotësohet vetëm nëse objekti i investimit është një letër me vlerë e emetuar nga një rezident në një treg financiar të huaj. Në të njëjtën kohë, shënohet edhe numri i identitetit të emetuesit të letrës me vlerë, nga regjistri i personave juridikë, të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.
- Në fushën **3.2 "Emri dhe selia"** shkruhet emri i plotë dhe selia e emetuesit të letrës me vlerë.
- Në fushën **3.3 "Shteti"** shkruhet shifra e shtetit në të cilin ndodhet selia e emetuesit të letrës me vlerë, nga numërori i shteteve që është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e kryerjes së qarkullimit të pagesave me shtetet e huaja.
- Në fushën **3.4 "Sektori institucional"** shkruhet shifra e sektorit të cilit i përket emetuesi i letrës me vlerë. Shtojcë-numërori i sektorëve të emetuesve është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi - 3. Sektori i emetuesit.
- Fusha **3.5 "Lloji i lidhjes me emetuesin"** shënohet me një nga shifrat e mëposhtme: 1 - nëse investuesi dhe emetuesi janë të lidhur me kapitalin duke marrë pjesë në kapital me *më pak se 10% ose aspak të lidhur me kapitalin*, 2 – nëse investuesi ka pjesëmarrje prej *10% ose mbi 10%* në kapitalin e emetuesit ose 3 – nëse emetuesi ka pjesëmarrje prej *10% ose mbi 10%* në kapitalin e investuesit.

Pjesa për kushtet dhe ndryshimet plotësohet në valutën e emetimit të letrës me vlerë.

Pjesa 4. **"Gjendja në fillim të periudhës"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **4.1 "Numri i l.v. në fillim të periudhës"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi kishte në portofolin e tij në fund të periudhës së mëparshme të raportimit.
- Në fushën **4.2 "Çmimi i tregut i një l.v. në fillim të periudhës"** shkruhet çmimi i tregut me të cilin vlerësohet letra me vlerë në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së mëparshme të raportimit*. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ka treg aktiv dhe çmimet e të cilave nuk kuotohen në një bursë përkatëse, shkruhet çmimi me të cilin vlerësohet letra në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së mëparshme të raportimit*. Në të njëjtën kohë, çmimi nuk duhet të përfshijë shumën e interesit të llogaritur.

Të dhënat e shënuara në pjesën 4. "Gjendja në fillim të periudhës" duhet të jenë identike me të dhënat që janë shënuar në pjesën 7. "Gjendja në fund të periudhës" nga Raporti VHV-2 për periudhën e mëparshme.

Pjesa 5. **"Transaksione me letra me vlerë"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **5.1.1 "Numri i l.v. të blera"** shkruhet numri i letrave me vlerë të blera nga investuesi gjatë periudhës të raportimit.
- Në fushën **5.1.2 "Çmimi i tregut i një l.v."** shkruhet çmimi i tregut me të cilin është blerë letra me vlerë. Nëse gjatë periudhës së raportimit investuesi blen në mënyrë të përsëritur të njëjtën letër me vlerë, çmimi mesatar i ponderuar i tregut shkruhet nga çmimet e tregut të të gjitha blerjeve të letrës përkatëse me vlerë. Numri i letrave me vlerë të blera gjatë periudhës të raportimit merret si ponder. Në të njëjtën kohë, çmimi i tregut nuk duhet të përfshijë shumën e interesit të blerë, as komisionet dhe shpenzimet e tjera të ndërmjetësimit që lidhen me transaksionin.
- Në fushën **5.2.1 "Numri i l.v. të shitura dhe të maturuara"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi i shiti gjatë periudhës së raportimit, përkatësisht numrin e letrave me vlerë që u maturuan gjatë periudhës të raportimit.
- Në fushën **5.2.2 "Çmimi i tregut i një l.v."** shkruhet çmimi i tregut me të cilin është shitur, përkatësisht letra me vlerë është maturuar gjatë periudhës të raportimit. Nëse gjatë periudhës së raportimit investuesi shet të njëjtën letër me vlerë shumë herë, çmimi mesatar i ponderuar i tregut shkruhet nga çmimet e tregut të të gjitha shitjeve të letrës përkatëse me vlerë. Numri i letrave me vlerë të shitura gjatë periudhës të raportimit merret si ponder. Në të njëjtën kohë, çmimi i tregut nuk duhet të përfshijë shumën e interesit të shitur, as komisionet dhe shpenzimet e tjera të ndërmjetësimit që lidhen me transaksionin.

Operacionet me letrat me vlerë të dhëna si kolateral, për shembull, në bazë të marrëveshjeve repo të lidhura, nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofol. Këto vazhdojnë të jenë në portofolin e investuesit që i përdor si kolateral dhe për rrjedhojë duhet të tregohen në bilancin përfundimtar të letrave me vlerë. Ngjashëm, letrat me vlerë të blera si kolateral, të tilla si në bazë të marrëveshjeve të anasjella repo, nuk duhet të përfshihen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofolin e investuesit. Këto letra me vlerë nuk duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar.

Gjithashtu, letrat me vlerë të dhëna hua në bazë të një marrëveshje huadhënieje letrash me vlerë nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofol. Këto vazhdojnë të jenë në portofolin e investuesit dhe në përputhje me rrethanat, duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar të letrave me vlerë. Ngjashëm, letrat me vlerë që janë marrë hua në bazë të një marrëveshjeje huadhënieje letrash me vlerë nuk duhet të futen në pjesën 5 - "Transaksione me letra me vlerë" sepse për këto letra me vlerë nuk ndodh asnjë ndryshim në portofolin e investuesit. Këto letra me vlerë nuk duhet të shfaqen në bilancin përfundimtar.

Pjesa 6. "Lëvizje të tjera" plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **6.1 "Ndryshime në çmime"** shkruhet vlera e të gjitha ndryshimeve të ndodhura, bazuar në dallimet e çmimeve gjatë periudhës të raportimit, të cilat ndikojnë në vlerën e gjendjes së investimeve në fund të periudhës së raportimit. Ndryshimet pozitive të çmimeve futen me parashenjë pozitive, ndërsa ato negative me parashenjë negative.
- Në fushën **6.2 "Ndryshime të tjera në numrin e l.v."** shkruhet numri i letrave me vlerë, i cili ndikon në gjendjen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit, por që mund të burojnë nga riklasifikimi ndërmjet sektorëve institucionalë, fshirjet, e të tjera, gjatë periudhës të raportimit. Ndryshimet e tjera të shënuara që shkaktojnë rritjen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit futen me parashenjë pozitive, ndërsa ndryshimet që shkaktojnë uljen e numrit të letrave me vlerë në fund të periudhës së raportimit futen me parashenjë negative.
- Në fushën **6.3 "Ndryshimet e tjera në shumë"** shkruhet vlera e të gjitha ndryshimeve të tjera në shumë, të ndodhura gjatë periudhës të raportimit, të cilat shkaktojnë një ndryshim në gjendjen e investimeve në fund të periudhës së raportimit. Këto ndryshime mund të burojnë nga riklasifikimi ndërmjet sektorëve institucionalë, fshirjet, e të tjera, gjatë periudhës të raportimit. Ndryshimet e tjera që shkaktojnë rritjen e bilancit përfundimtar të investimeve futen me parashenjë pozitive, ndërsa ndryshimet që shkaktojnë uljen e bilancit përfundimtar të investimeve futen me parashenjë negative.

Pjesa 7. "Gjendja në fund të periudhës" plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **7.1 "Numri i l.v. në fund të periudhës"** shkruhet numri i letrave me vlerë që investuesi ka në portofolin e tij në fund të periudhës të raportimit.
- Në fushën **7.2 "Çmimi i tregut të një l.v. në fund të periudhës"** shkruhet çmimi i tregut me të cilin vlerësohet letra me vlerë në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së raportimit*. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ka treg aktiv dhe çmimet e të cilave nuk kuotohen në një bursë përkatëse, shkruhet çmimi me të cilin vlerësohet letra në portofolin e investuesit në *fund të periudhës së raportimit*. Në të njëjtën kohë, çmimi nuk duhet të përfshijë shumën e interesit të llogaritur.

Formula e mëposhtme përdoret për të vërtetuar saktësinë e bilancit përfundimtar të investimeve në letra me vlerë:

- Bilanci përfundimtar = bilanci fillestar + blerja l.v. (në periudhën të raportimit) - shitja dhe maturimi i l.v. (në periudhën të raportimit) + /- ndryshime në çmim (në periudhën të raportimit) +/- ndryshime të tjera në shumë (në periudhën të raportimit).

Pjesa **8. "Interes"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **8.1 "Gjendja në fillim të periudhës"** shkruhet shuma e interesit të llogaritur në *fund të periudhës së mëparshme të raportimit*.
- Në fushën **8.2 "Interesi i blerë"** shkruhet shuma e interesit që investuesi ka blerë së bashku me blerjen e letrës me vlerë gjatë periudhës të raportimit.
- Në fushën **8.3 "Interesi i shitur dhe i shlyer"** shkruhet shuma e interesit që investuesi ka shitur së bashku me shitjen e letrës me vlerë, pra shuma e interesit që investuesi ka mbledhur gjatë periudhës së raportimit.
- Në fushën **8.4 "Interesi i llogaritur"** shkruhet shuma e interesit që i takon investuesit dhe që është akumuluar, përkatësisht e llogaritur për periudhën e raportimit, pavarësisht se kur duhet të shlyhet.
- Në fushën **8.5 "Ndryshime të tjera"** shkruhet shuma e interesit që buron nga ndryshimet e tjera në letrat me vlerë, pra nga riklasifikimi, fshirjet, e të tjera, gjatë periudhës së raportimit.
- Në fushën **8.6 "Gjendja në fund të periudhës"** shkruhet shuma e interesit të llogaritur në *fund të periudhës së raportimit*.

Formula e mëposhtme përdoret për të vërtetuar saktësinë e bilancit përfundimtar të interesit:

- Bilanci përfundimtar = bilanci i interesit në fillim të periudhës + interesi i blerë (në periudhën e raportimit) - interesi i shitur/mbledhur (në periudhën e

raportimit) + interesi i llogaritur (në periudhën e raportimit) +/- ndryshime të tjera (në periudhën e raportimit).

Pjesa **9. "Shpenzime"** plotësohet në këtë mënyrë:

- Në fushën **9.1 "Shpenzime për ndërmjetësimin"** shkruhet shuma e komisioneve dhe e shpenzimeve të tjera të ndërmjetësit në lidhje me të gjitha transaksionet e blerjes, shitjes dhe ruajtjes së letrës me vlerë përkatëse, të bëra gjatë periudhës së raportimit. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e ndërmjetësit të shkaktuara vetëm ndaj ndërmjetësuesit financiar *jorezident*, përkatësisht shpenzimet e ruajtjes së letrës me vlerë të bëra vetëm ndaj bankës depozituese *jorezidente*.

11. Shpjegime më të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së të dhënave, nënshkrimin elektronik, kodimin e të dhënave, formatin elektronik, si dhe kontrollet e integruara logjike dhe matematikore gjenden në Udhëzuesin teknik për aplikacionin e-VHV dhe Metodologjinë e raportimit të formularëve VHV.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

12. Me fillimin e zbatimit të këtij udhëzimi, pushon së vlefshmi Udhëzimi për zbatimin e Vendimit për raportimin e punëve me letrat me vlerë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/02 dhe 24/03).

13. Ова упатство влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе се применува од 1.1.2015 година.

Guvernatori
Dimitar Bogov

Прилог шифрарници

1. Сектор на инвеститорот

Шифра	Назив на сектор и потсектор
1	Вкупна економија
11	Нефинансиски друштва
11001	Јавни нефинансиски друштва
11002	Домашни приватни нефинансиски друштва
11003	Нефинансиски друштва контролирани од странство
12	Финансиски друштва
121	Централна банка
122	Друштва кои прибираат депозити освен централна банка
12201	Јавни друштва кои прибираат депозити освен централна банка
12202	Домашни приватни друштва кои прибираат депозити освен централна банка
12203	Друштва кои прибираат депозити освен централна банка контролирани од странство
123	Фондови на пазарот на пари
12301	Јавни фондови на пазарот на пари
12302	Домашни приватни фондови на пазарот на пари
12303	Фондови на пазарот на пари контролирани од странство
124	Инвестициски фондови на непаричниот пазар
12401	Јавни инвестициски фондови на непаричниот пазар
12402	Домашни приватни инвестициски фондови на непаричниот пазар
12403	Инвестициски фондови на непаричниот пазар контролирани од странство
125	Други финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
12501	Други јавни финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
12502	Други домашни приватни финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
12503	Други финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови контролирани од странство
126	Помошни финансиски институции
12601	Јавни помошни финансиски институции
12602	Домашни приватни помошни финансиски институции
12603	Помошни финансиски институции контролирани од странство
127	Затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
12701	Јавни затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
12702	Домашни приватни затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
12703	Затворени финансиски институции и позајмувачи на пари контролирани од странство
128	Осигурителни друштва
12801	Јавни осигурителни друштва
12802	Домашни приватни осигурителни друштва
12803	Осигурителни друштва контролирани од странство
129	Пензиски фондови
12901	Јавни пензиски фондови
12902	Домашни приватни пензиски фондови
12903	Пензиски фондови контролирани од странство
13	Држава
1311	Централна влада
1313	Локална самоуправа
1314	Фондови за социјално осигурување
14	Домаќинства
141	Работодавачи и работници за своја сметка
143	Вработени
144	Приматели на доход од сопственост и доход од трансфери
15	Непрофитни институции кои им служат на домаќинствата

2. Видови хартии од вредност

ВХВ - 1	
Шифра	Вид на хартија од вредност
1	Акции и други сопственички хартии од вредност
11	<i>Котирана акција</i>
111	<i>Котирана обична акција</i>
112	<i>Котирана приоритетна акција</i>
113	<i>Котирана непартиципативна приоритетна акција ¹⁾</i>
114	<i>Останати котирани сопственички хартии од вредност</i>
12	<i>Некотирана акција</i>
121	<i>Некотирана обична акција</i>
122	<i>Некотирана приоритетна акција</i>
123	<i>Некотирана непартиципативна приоритетна акција</i>
124	<i>Останати некотирани сопственички хартии од вредност</i>
130	<i>Потврда за поседување хартии од вредност - ГДР</i>
2	Удел/акција во инвестициски фондови
21	<i>Удел</i>
211	<i>Удел во фонд на пазар на пари</i>
212	<i>Удели во останати инвестициски фондови</i>
22	<i>Акција</i>
221	<i>Акција на фонд на пазар на пари</i>
222	<i>Акции на останати инвестициски фондови</i>
ВХВ - 2	
Шифра	Вид на хартија од вредност
3	Должничка хартија од вредност
31	<i>К упонска должничка хартија од вредност</i>
32	<i>Бескупонска должничка хартија од вредност</i>
33	<i>Останати должнички х.в.</i>

¹⁾ Непартиципативните приоритетни акции му даваат на инвеститорот право на фиксна дивиденда, меѓутоа не му даваат право на учество во остатокот од вредноста на претпријатието- издавач, во случај на ликвидација.

3. Сектор на издавачот

Шифра	Назив на сектор и потсектор
3	Сектор нерезиденти
31	Нефинансиски друштва
31001	Јавни нефинансиски друштва
31002	Приватни нефинансиски друштва
32	Финансиски друштва
321	Централна банка
322	Друштва кои прибираат депозити освен централна банка
32201	Јавни друштва кои прибираат депозити освен централна банка
32202	Приватни друштва кои прибираат депозити освен централна банка
323	Фондови на пазарот на пари
32301	Јавни фондови на пазарот на пари
32302	Приватни фондови на пазарот на пари
324	Инвестициски фондови на непаричниот пазар
32401	Јавни инвестициски фондови на непаричниот пазар
32402	Приватни инвестициски фондови на непаричниот пазар
325	Други финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
32501	Други јавни финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
32502	Други приватни финансиски посредници освен осигурителни друштва и пензиски фондови
326	Помошни финансиски институции
32601	Јавни помошни финансиски институции
32602	Приватни помошни финансиски институции
327	Затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
32701	Јавни затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
32702	Приватни затворени финансиски институции и позајмувачи на пари
328	Осигурителни друштва
32801	Јавни осигурителни друштва
32802	Приватни осигурителни друштва
329	Пензиски фондови
32901	Јавни пензиски фондови
32902	Приватни пензиски фондови
33	Држава
3311	Централна влада
3313	Локална самоуправа
3314	Фондови за социјално осигурување
34	Домаќинства
341	Работодавачи и работници за своја сметка
343	Вработени
344	Приматели на доход од сопственост и доход од трансфери
35	Непрофитни институции кои им служат на домаќинствата
36	Меѓународни финансиски организации

4. Видови каматни стапки

Шифра	Каматна стапка
0101	Либор 1 м.
0102	Либор 2 м.
0103	Либор 3 м.
0104	Либор 4 м
0105	Либор 5 м.
0106	Либор 6 м
0107	Либор 7 м.
0108	Либор 8 м.
0109	Либор 9 м.
01010	Либор 10 м.
01011	Либор 11 м.
01012	Либор 12 м.
0801	Еурибор 1 м.
0802	Еурибор 2 м.
0803	Еурибор 3 м.
0804	Еурибор 4 м.
0805	Еурибор 5 м.
0806	Еурибор 6 м.
0807	Еурибор 7 м.
0808	Еурибор 8 м.
0809	Еурибор 9 м.
0810	Еурибор 10 м.
0811	Еурибор 11 м.
0812	Еурибор 12 м.
20	Фиксна стапка
30	Без камата

Formularë në shtojcë

Образец ВХВ - 1

стр. 1 од 2

ИЗВЕШТАЈ ЗА СОСТОЈБАТА И ПРОМЕНЕТЕ НА ВЛОЖУВАЊАТА ВО СОПСТВЕНИЧКИ ХАРТИИ ОД ВРЕДНОСТ И УДЕЛИ ВО ИНВЕСТИЦИСКИ ФОНДОВИ[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

